

Relacion teknik i projekt zbatimit


Vijim I sistemimit të rrugës "Velaj" Allambres

1. HYRJE

Me fonde nga buxheti i Bashkisë parashikohet sistemimi dhe asfaltimi i disa rrugëve rurale të lagjeve të cilat shërbejnë si rrugë lidhëse të këtyre lagjeve me rrugën kryesore të fshatit. I cili është në administrimin e Bashkisë Dimal.

E konkretisht Bashkia Dimal, me fonde nga buxheti i vetë, do të rikonstruktojë rrugën "Velaj" fshati Allambres.

Sfidat me të cilat do të përballë pushteti vendor janë të shumta por kryesore mbetet hartimi i politikave për gjithëpërfshirjen e zonave të ndryshme në strategjitë e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor. Bashkisë i nevojitet hartimi dhe mbështetja e një plani konkret të nxitjes së biznesit vendas duke realizuar reabilitimin e rrugës, qoftë gjatë sezonit veror qoftë gjatë atij dimëror. Sektori i bujqësisë ofron mundësi punësimi sidomos për banorët në zonat rurale dhe bashkisë së re i duhet që të mbështesë dhe nxisë rritjen e kapaciteteve të punësimit në këtë drejtim. Prezantimi i aseteve kulturore, kulturës dhe kulinarisë janë një tjetër prizëm që identifikohet si sfida.





TË PERGJITHSHME

Asetet bujqësore në këtë zonë janë të shumta por mungesa e infrastrukturës bëhet një pengesë serioze për të gjetur tregun.

Rritja e fluksit të transportit për prodhimet bujqësore të banorëve të zonave rurale që administrohen nga Bashkia Dimal shton detyrimin për një infrastrukturë standarte dhe komode. Vecanërisht kërkohet që rrjeti rrugor të ketë parametrat e duhura dhe të jetë kompatibël me rrjetin rrugor kombëtar në mënyrë që levizja e mallrave apo komunitetit të bëhet në mënyrë të sigurtë dhe në kohë sa më të shkurter.


Analizat e deritanishme të trafikut në këto akse rrugore të parashikuara për investim, japin një numër gjithnjë në rritje të fluksit të mjeteve ditore e cila në periudhë të pikut të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dyfishohet.

Ajo çfarë kërkohet nëpërmjet këtyre Termave është që të bëhet një studim i detajuar teknik, ambiental dhe ekonomik për hartimin e një projekti të mirëfilltë për sistemimin asfaltimin dhe apo rehabilitimin e këtyre akseve rrugore të cilat do të bëjnë të mundur lidhjen e fshatrave nga kalojnë këto rrugë, lidhjen në mes tyre si dhe lidhjen me qendrën e Bashkisë apo dhe me rrugët kombëtare të cilat kalojnë në këto zonë.

Ajo është zonë e begate dhe ndodhet në Bashkinë Ura Vajgurore, në pjesën veri perndimore të kësaj zone. Për të arritur në këtë zonë të banuar, duhet ndjekur rruga automobilistike e asfaltuar Krotinë-Cetë dhe më pas, ky aks kalon nëpër fshatin Allambrez. Përveç natyrës së bukur, do të njihet me traditën, etnografinë e veçantë dhe kulinarinë e zonës. Allambrez është një vend mjaft i përshtatshëm për prodhimet bujqësore e blegtorale si dhe kulturën e ullirit.

3- PERSHKRIMI PROJEKTIT

Bashkia Dimal ka për qëllim rikonstruktimin e rrugës në përputhje me standartet Europiane për ta kthyer atë në një aks rrugor me tepër funksional. Rikonstruksioni do të përmbajë unifikimin, shtrimin e rruges, lehtësimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara, dhe të asaj mbi tokë me theks të vecantë në realizimin eficientë.



4- HARTIMI I PROJEKTIT

Rruga "Velaj" fshati Allambrez duke qene se paraqet nje planimetri te ndryshueshme ne gjatesine e tij do te kete trajtim te vecante ne secin prej segmenteve te tij.

Ky segmenti, ka një shtrirje gjatesi 600 ml në një formacion të qëndrueshëm ne disa pjesë ka cedime të cilat do të trajtohen duke nderhyre ne nenshtresa sipas detajit tip shtrese me bitum Ka një gjerësi aktuale që varion nga 3.5-4.2 ml.

Punimet qe do te kryhen jane :

a) Rikonstruksioni i trupit te rruges duke perfshire shtresat rrugore te cilat do te zevendesohen, kjo do te realizohet duke skarifikuar shtresat ekzistuese deri ne binder 5 cm.

Ngeshja duhet të realizojë një shtresë kompakte në mënyre që të mos kemi ulje të ndryshme nga trupi i rrugës ekzistuese.

Gjersia e rruges do të jetë variabel sipas gjerësisë aktuale 3.5 m bitum

f) Sistemi i ujrave siperfaqesore do te realizohet duke ndertuar kanale anesore dhe largimi i ujrave do te behet me ane te nje rrjeti të hapur. Pika e shkarkimit per ujrat e shiut do te jenë ne rrjedhje të lirë jashtë trupit të rrugës ne kanal anesor.

5- PARAMETRAT TEKNIK TE RRUGES

5.1 Gjeometria e Rruges, pas perpunimit te dhenave gjeodezike te mara nga rilevimi faktik i kryer ne terren dhe ne konsultim me te dhenat e kerkuara ne termat e references rruga duhet te ruaj format ekzistuese ne pjesen dermuese te saj ne rafshin horizontal, sepse kjo forme e propozuar dhe e ekzekutuar ne terren. Elementet ndertimor do te jene ne perputhje dhe harmoni.

5.2 Profili gjatesore, (Niveleta) duke ju referuar gjendjes ekzistuese te rruges na rezulton se nuk kemi deformime te medha te niveletes te cilat nuk krijojne disnivele. Per te mos cenuar aksesin e banesave dhe infrastrukturen sekondare qe nderthuret me objektin tone, propozojme qe kuotat e projektit tone te jene te njejta me ato ekzistuese, pra ne kete menyre te gjitha punimet te kryhen poshte ketij niveli dhe ne perfundim shtresat e reja te ngelet i pa ndryshuar ne kuote.

5.3 Format niveluese, trafiku ne trasene e rruges do te zhvillohet ne nje nivel, gjithsej kemi një kalim per automjete.

5.4 Konstruksioni, per rikonstruksionin e rruges jane parashikuar 2 shtresa cakëll, 10 cm stabilizant dhe shtresa bitum tashesi 6 cm, kjo per faktin se ne kete aks eshte i lejushem qarkullimi i mjeteve te lehta dhe jo me ngakese, gjithashtu eshte gjykuar qe te shkohet me thelle me shtresat pasi bazamenti i rruges paraqet demtime te cilat do te kerkonin dhe shtresa te tjera si baze apo nen baze.

5.5 Seksioni tip i rruges, duke qene se planimetria e rruges tone paraqet ndryshime dhe nuk eshte uniforme lind nevoja qe te aplikohen seksione tip perkundrejt ndryshimeve planimetrike qe paraqiten.

5.6 Veprat e artit, duke qene se jemi ne nje zone urbane dhe infrastruktura eshte totalisht ekzistuese dhe objekt i projektit eshte rikonstruksion i saj dhe ky rikonstruksion nuk do te shkoj ne shtresa te thella paraqet nevojte per ndertimin apo rikonstruksionin e tombinove.

5.7 Siguria dhe sinjalistika rrugore, meqenese ne kete aks rruge nuk kemi levizje me intensitet te larte te automjeteve dhe kembesoreve dhe shpesh levizja e tyre nderthure parashikohet qe cilesia e materjaleve si horizontale ashtu dhe vertikale te jete e cilesise me te larte. Ne te gjitha situatat ku do te kemi inersektim te kalimeve te tilla si, kembesore - automjete, do te parashikohen te gjitha elementet sinjalizues te nevojshem. Gjate kohes se kryerjes se punimeve ne rruges pervec masave te sigurimit do te merren dhe masat e sigurise ne rruge duke vendosur sinjalistiken e perkoheshme te nevojshme sipas kodit rrugor.

5.8 Shpronsimet, meqenese projekti zhvillohet brenda dimensioneve ekzistuese te rruges pa pasur nevojte per zgjerime apo ndryshime te gjurmes se rruges nuk kemi nevojte per shpronsime.

5.9 Organizimi i punimeve dhe preventivi, per ndertimin e rruges eshte parashikuar qe materialet e ndertimit te merren konform specifikave teknike dhe provave laboratorike te percaktuarane specifikimet teknike. Fabrika e prodhimit te asfalteve, betoneve dhe para-fabrikateve te jene te gjitha larg objektit te ndertimit duke ruajtur te gjitha kondicionet e percaktuara ne studimin e ndikimit ne mjedis qe i bashkengjitet ketij projekti. Te gjitha dherat e dala nga germimet dhe materialet e teperta te pa pershtatshme do te parashikohen te transportohen e sistemohen ne vende te posacme te paracaktuara nga institucioni administrues ne marveshje me supervisorin dhe pushtetin lokal. Te gjitha punimet jane parashikuar ne perputhje me specifikimet teknike qe i bashkengjiten ketij projekti. Preventivi i punimeve do parashikohet me pjese te vecanta sipas vecorive te punimeve dhe ne nje tabelë permbledhese per te gjitha projektin. Në preventiv do te parashikohen te gjitha zërat e punimeve te ketij projekti me cmimet e manualit te MZHU.

Bashkengjitur ketij raporti do te jene: Specifikimet teknike te punimeve, volumet e punimeve me vleresimet e kostove (preventivi), volumet metrike te punimeve, raporti i punimeve topo-gjeodezike dhe raporti i vleresimit te mjedisit.

6- PERFUNDIME

Ndertimi i ketij aksi rrugor eshte mjaft i rendesishem per keto arsyje :

- a) Permireson kushtet e levizjes se automjeteve dhe kembesoreve ne kete aks
- b) Disiplinon trafikun ne pergjithsi ne kete segment
- d) Implementimi i ketij projekti do te japi nje efekt pozitiv financiar ne komunitet

- Projekti do te hartohet nga inxhinier specialiste te Drejtorise se Planifikimit , dhe nga nje grup i gjere bashkepuntoresh.nqs do të dalin punime të paparashikuara do të njoftohet projektuesi i cili do të japi edhe mënyrën e ndërhyrjes me shkrim dhe skicat përkatëse.

- Bashkengjitur ketij relacioni teknik te projekt zbatimit do te jepen materialet grafike te projektit si, planimetria e pergjithshme e propozuar si variant si dhe profilet tipe dhe detajet e elementeve qe do te implementohen ne kete projekt.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT

Redina Hoxhi

Anton Hoxhi

Nezir Guri